



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.75, datë 19.03.2021

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR.
34, DATË 04.02.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR
SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 02.11.2007, I
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 dhe nenit 92, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/3 prot., datë 17.03.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe propozimin e Këshilltares së bordit të ERE-s,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 34, datë 04.02.2021, vendosi:
 1. *Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar.*
 2. *Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., nr. 49, seria NPM07P.*
 3. *Shoqëria “HERA” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.*
- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimmarrje të bordit të ERE-s nëpërmjet shkresës nr. 300 prot., datë 13.02.2021, përmes së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme, me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.
- Brenda afatit 30 ditor, brenda të cilit shoqërisë i jepet e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 300/1 prot., datë 17.02.2021, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së bordit, me qëllim që t'i jepet mundësia shoqërisë të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për sa pretenduar nga ajo në kuadër të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit nr. 34/2021

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021.
2. Shoqëria “HERA” sh.p.k., brenda 10 ditëve pune të dokumentojë në ERE sa pretenduar në shkresën nr. 300/1 prot., datë 17.02.2021.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes si dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI